



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:064658
Datë: 05.11.2018
Numri i dokumentit: 00161656

P. nr. 973/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.R. nga fsh. ..., K. e ... të cilin sipas autorizimit e mbron av. A.H. nga ..., për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188, par.2 lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP II.nr. 1627/2018, të datës 13.10.2018, të cilin e përfaqëson prokurorja Huma Jetishi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, lidhur me Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, më datën 26.10.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa, më dt. 05.11.2018, përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.R.**, nga babai E. dhe nëna R., e lindur H., i lindur më datë ... në fsh. ..., ku edhe jeton, me nr. personal ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, pronar i shitores “ ... ” në Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datën 12.10.2018, rreth orës 16:00 min., në fsh. Pozharan, K. e Vitisë, me dashje i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit Z.R., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje rreth një postimi në “Face book” nga i dëmtuari, fillimisht kanë biseduar në telefon, e më pas i dëmtuari ka shkuar në shtëpinë e të akuzuarit për t’u sqaruar dhe aty i akuzuari, me një shkop druri rreth dy metra të gjat, mjet i rrezikshëm, i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, e ka goditur të dëmtuarin në kokë dhe në pjesë të ndrayshme të trupit, i cili ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe ka kërkuar ndihmë mjeksore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit, nga ku, për trajtim të mëtejshëm është dërguar në QKUK në Prishtinë,

-me çka ka kryer vepër penale **Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188, paragrafi 2 lidhur me par.1 nënpar.1.4** të KPRK-së, andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

E G J Y K O N M E D Ë N I M M E B U R G

Të akuzuarin E.R. me dënim **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, të cilin dënim do ta vuajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën, dënimi i me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, duke llogaritur në të kundërtën, dënimi i përmendur do t'i shndërrohet në dënim burgu, duke llogaritur për çdo 20 €, një ditë burgu.

Në dënimin e përmendur, të akuzuarit i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 12.10.2018 deri më datën 26.10.2018.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej **20 (njëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë me nr. PP.nr.1627/2018, të datës 25.10.2018, kundër të akuzuarit E.R., për shkak të veprës penale, **Lëndimi i lehtë trupor** nga neni 188, paragrafi 2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim meritore.

Përfaqësuesja e akuzës, prokurorja Huma Jetishi, e ka njoftuar gjykatësen e vetme gjyqësore të kësaj çështje për marrjen e pëlqimit nga kryeprokurori për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke hequr dorë nga ndëgjimi i dëshmitarëve dhe shtjellimi i provave materiale.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.R., av. A.H., poashtu ka njoftuar gjykatësen e vetme të çështjes për marrëveshje me përfaqësuesin e akuzës, në prezencë të të akuzuarit, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe shtjellimin e provave materiale.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke dhënë deklaratë me shkrim se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njejtë marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata ka vërtetuar se e akuzuara e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Përfaqësuesja e akuzës, e akuzuari dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. A.H., kanë hequr dorë nga drejta në ankesë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e pranoi fajsinë për veprën penale falje të dëmtuarit, i cili edhe është pajtuar që i njejtë të arrijë marrëveshje për pranimin e fajësisë, ndërsa, si rrethana rënduese, mori peshën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 973/2018, më datë 05.11.2018

Sek.juridike,
Rafete Syla

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: *palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi*